VENDIM
Nr. 178, datë 14.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "KROI MBRET ENERGJI" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: "BACKA 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1600 kw; HEC-i "BACKA 2", ME KAPACITET TË INSTALUAR 4000 kw, HEC-i "BACKA A", ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw, HEC-i "BACKA B", ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw, HEC-i "BACKA C", ME KAPACITET TË INSTALUAR 720 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 7320 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1 germa "a", nenit 10, pika 1 dhe 3, 4 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., si dhe relacionin nr. 102/4 prot., datë 11.11.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 634 prot., datë 11.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, me cilësinë e "Autoritetit kontraktues", e përcaktuar si e tillë në bazë të VKM-së nr. 616, datë 7.9.2011, "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues dhe dhënien me koncesion të hidrocentraleve 'Stravecka 1' dhe 'Stravecka 2' dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë", ka lidhur me shoqërinë "Alba Konstruksion" sh.p.k., me cilësinë e koncesionarit, kontratën e koncesionit të formës "BOT" nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, "Për financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e HEC –eve, 'Backa 1', 'Backa 2', 'Backa A', 'Backa B', 'Backa C' dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës, nga koncesionari tek autoriteti kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate".

- Kapaciteti total për të cilin kërkon të licencohet shoqëria është i njëjtë në kontratën e koncesionit dhe në projektin e zbatimit, por në projektin e zbatimit është referuar për HEC-et emërtesa sipas vendndodhjes ku do të ndërtohet secili dhe janë shtuar veprat e marrjes për HEC-et "Backa A", "Backa B" dhe "Backa C".

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 92/15 prot., datë 16.2.2015, drejtuar shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., dhe për dijeni AKBN-së, ka përcjellë te këto të fundit: "Miratimin e ndryshimit të projektit të zbatimit të miratuar me shkresën nr. 92/3 prot., datë 4.4.2013 të HEC-ve "Backa 1", "Backa 2", "Backa A", "Backa B", "Backa C".

- Kontrata e koncesionit ka një kohëzgjatje prej 35 vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- Koncesionari merr përsipër të vendosë në punë hidrocentralin brenda 15 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit, siç parashikuar në grafikun e punimeve, të paraqitur në aneksin 2 të kontratës.

- Nga aplikimi rezulton se të gjitha veprat hidroenergjetike janë ndërtuar që në vitin 2016 dhe pritet të vihen në punë në nëntor të vitit 2019.

- Aplikimi i shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim-neni 9, pika 1, germa "a", germa "b", germa "c", janë plotësuar;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor-neni 9, pika 2: germat "a"/"b", germa "c"; germa "d", germa "e", germa "f" dhe germa "g" janë plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal-neni 9, pika 3, germa "a", germa "b", germa "c", germa "d", janë plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për HEC-et:

- neni 9, pika 4.1.1, të dhënat teknike për HEC-et, janë plotësuar;

- neni 9, pika 4.1.2, të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, janë plotësuar pjesërisht;

- neni 9, pika 4.1.3, dokumentacioni teknik dhe grafik: germa "a", germa "b", germa "c", germa "d", janë plotësuar pjesërisht;

- neni 9, pika 4.1.4, dokumentacioni tekniko-ekonomik: germa "a", germa "b", germa "c", germa "d", germa "e", janë plotësuar pjesërisht.

- Leje nga institucione të tjera-neni 9, pika 4.1.5: germa "a", germa "b", germa "c", janë plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2.

- Germa "f" (Marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës):

- shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., ka paraqitur kontratën e koncesionit nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, të lidhur midis palëve: Koncesionarit "Alba Konstruksion" sh.p.k. dhe METE-s, me cilësinë e autoritetit kontraktues, "Për ndërtim-operimin dhe transferimin e hidrocentraleve: "Backa 1", "Backa 2", "Backa A", "Backa B", "Backa C", me përfundimin e periudhës së përcaktuar në kontratën e koncesionit tek autoriteti kontraktues.

- MIE, me shkresën, nr. 92/15 prot., datë 16.2.2015, ka dhënë "Miratimin e ndryshimit të projektit të zbatimit të miratuar me shkresën nr. 92/3 prot., datë 4.4.2013 të HEC-ve "Backa 1", "Backa 2", "Backa A", "Backa B", "Backa C".

- Germa "g" (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtimi shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti):

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, nr. 3487 prot., datë 20.11.2018, të lidhur midis palëve: Bashkia Skrapar, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për një afat 1 (një) vjeçar, e cili fillon nga dita e nesërme e nënshkrimit të saj.

- Objekti i kësaj kontrate është :"Dhënia me qira e fondit pyjor/kullosor me gjatësi lineare 6.972 km, nga të cilat 0.87 km shkurre, 6.1 km kullotë, e përfshirë në ekonominë pyjore Turbohovë-Potom, Ek Backë, në administrim/pronësi të Bashkisë Skrapar, shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë për ndërtimin e hidrocentraleve: "Backa 1" ,"Backa 2", "Backa A", "Backa B" dhe "Backa C" në pellgun ujëmbledhës, përroi Backës, Straveckë.

- Kontrata e lidhur nga palët, për një periudhë njëvjeçare, për shkak të përfundimit të afatit të ushtrimit të veprimtarisë, humbet fuqinë juridike në datën 20.11.2019.

- Në kontratë mungojnë numrat kadastral të parcelave ku shtrihet projekti.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal-neni 9, pika 3:

- Germa "b" (bilanci financiar i tre viteve të fundit). Shoqëria ka paraqitur pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2018, nga të cilat rezulton se ka ushtruar aktivitetin për ndërtimin e hidrocentralit Potom Skrapar dhe nuk rezulton të ketë gjeneruar fitim.

- Germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Shoqëria ka paraqitur vërtetimin nr. 213, prot., datë 2.9.2019, të lëshuar nga Credins Bank, i cili vërteton se shoqëria ka llogari aktive në lekë, me gjendje kreditore 300.000.000 ALL (treqind milionë lek). Për pjesën tjetër të investimit, për të cilën është parashtruar më poshtë në Planin e Biznesit, vlera e investimit që shoqëria mbulon nëpërmjet kredisë rezulton të jetë 80%.

- Neni 9, pika 4.1.3. Dokumentacioni teknik dhe grafik-germa "c". Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastre) dhe të paraqitura në harte me shkallë 1:25000. Nga ky dokumentacion rezulton se janë përcaktuar koordinatat e shtrirjes së projektit, por nuk janë përcaktuar numrat e parcelave dhe numrat e regjistrit të kadastrës.

- Neni 9, pika 4.1.4. Dokumentacioni tekniko-ekonomik-germa c. Oponenca teknike e projektit. Shoqëria ka depozituar në ERE vetëm Raportin e Oponencës Teknike mbi projektin e zbatimit të HEC-ve: "Backa 1" ,"Backa 2", "Backa A", "Backa B" dhe "Backa C" , miratuar nga MIE me shkresën nr. 92/15 prot., datë 16.2.2015.

- Leje nga institucione të tjera- neni 9, pika 4.1.5, germa b. Leja e përdorimit të ujit.

Shoqëria ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Agjencia e Ujit, të Basenit Seman, nr. 442 prot., datë 9.11.2011, ku citohet: "Vërtetojmë se Subjekti 'Alba Konstruksion' sh.p.k, ka depozituar pranë AUB Seman, kërkesën për shfrytëzimin e përroit të Staroveckës, për leje për miratim në parim në datë 9.11.2011. Shoqëria "Alba Konstruksion" sh.p.k, parashikon të shfrytëzojë këtë përrua për HEC-et: HEC "A", HEC "C", HEC "B", HEC "1", HEC "2', sipas të dhënave teknike përkatëse.

- Kontrata e koncesionit, e formës "BOT", nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, ka një afat 35-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE-ja, në zbatim të nenit 38, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk mund të lëshojë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

- Sipas llogaritjes së afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit të formës "BOT", me nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, rezulton se shoqëria ka humbur 7 vjet e 4 muaj nga periudha koncesionare dhe periudha e mbetur për licencim është 22 vjet e 8 muaj.

- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

- Në pikën 4, të nenit 8, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" parashikohet se: Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes se lejeve nga institucionet e tjera.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et: "Backa 1", me kapacitet të instaluar 1600 kw; "Backa 2", me kapacitet të instaluar 4000 kw, "Backa A", me kapacitet të instaluar 500 kw; "Backa B", me kapacitet të instaluar 500 kw dhe "Backa C", me kapacitet të instaluar 720 kV, me kapacitet total 7320 kw, për periudhën e mbetur nga afati i parashikuar në kontratën e koncesionit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti